



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK

VENDIM

Nr. 8, datë 27/04/2021

MBI

“DEKLARIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT TË STUDENTËVE TË CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË BACHELOR DHE TË CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË MASTER I ARTEVE, MASTER I SHKENCAVE DHE MASTER PROFESIONAL PËR VITIN AKADEMIK 2021-2022, NË UNIVERSITETIN E ARTEVE”

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në pikën 3 të nenit 69 e në vijim të ligjit nr. 80/2015, për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, nisur dhe nga propozimet mbi deklarimin e kuotave për të gjitha programet e studimit të ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë Bachelor dhe të ciklit të dytë të studimeve me kohë të plotë Master, të ofruara nga Fakultetet e Universitetit të Arteve, bashkëlidhur këtij vendimi dhe më konkretisht shkresave të Fakultetit të Muzikës me nr. 23/1 prot., datë 01.03.2021 (protokolluar në Rektorat me nr. 115/1 Prot., datë 01.03.2021), Fakultetit të Artit Skenik me nr. 100 prot., datë 24.02.2021 (protokolluar në Rektorat me nr. 136 prot., datë 24.02.2021) dhe të Fakultetit të Arteve të Bukura me nr. 15 prot., datë 01.03.2021 (protokolluar në Rektorat me nr. 144 Prot., datë 02.03.2021), pasi diskutoi mbi “Deklarimin e kuotave të pranimit të studentëve të ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë Bachelor dhe të ciklit të dytë të studimeve me kohë të plotë Master i Arteve, Master i Shkencave dhe Master Profesional për vitin akademik 2021-2022, në Universitetin e Arteve”, unanimisht,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kuotave të pranimit të studentëve të ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë Bachelor, të ciklit të dytë të studimeve me kohë të plotë Master i Arteve/Master i Shkencave dhe Master Profesional, për vitin akademik 2021-2022, në Universitetin e Arteve, sipas lidhjes të bashkëngjitur këtij vendimi
2. Ky vendim ti përcillet MASR së bashku me tabelat e deklarimit të kuotave për secilin fakultet sipas programeve të studimit.
3. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve tek transparenca si dhe në portalin U-Albania.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

